



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.05.2025, Operatori Ekonomik Marisa SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “Marisa” SH.P.K., e dt.16.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 28.02.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Korigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 28.02.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K., me dt.16.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan - Rakovinë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pajisa nr. 1 - Gjysërimorkio për bartjen e makinerisë nuk është kërkuar pesha e saj vetëm është kërkuar që gjysmë-rimorkio të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit – KJO KËRKESË NUK NDRYSHOHET.

Pajisja nr. 20 - Finisher për shtrirjen e asfaltit mbi 25t, është kërkuar finisher i madh prandaj minimumi i peshës së tij duhet të jetë 25t - KJO KËRKESË NUK NDRYSHOHET.

Pajisja nr. 21 - Finishera për shtrirjen e asfaltit 16deri18t, HIQET NGA LISTA sepse mund të zëvendësohet me pajisjen nr. 22

Pajisja nr. 23 - Finishera për shtrirjen e asfaltit 10deri12t, NDRYSHOHET NË: Finisher për shtrirjen e asfaltit deri 12t

Pajisja nr. 24 - Luge hidraulike ripper 2.5 deri 3t - është mjet i nevojshëm për kryerjen e punimeve - KJO KËRKESË NUK NDRYSHOHET

Pajisja nr. 25 - Freze që montohet në bager deri 500kg, është kërkuar pesha maksimale e saj pra pranohen edhe me pesha më të lehta - KJO KËRKESË NUK NDRYSHOHET.

Pajisja nr. 26 - Ndriqes me gjenerator 3.5kva 900-1000kg, NDRYSHOHET NË: - Ndriqes me gjenerator 3.5kva.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

